



Periodik mujor

Nr. 179

Prill 2024

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive
e AMF-së merr pjesë
në prezantimin e fondit
më të ri të investimeve**

Tregu i Sigurimeve, Janar-Mars 2024

VËSHTRIM MBI TREGJET

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

5 - 12

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

13-14

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së merr pjesë në prezantimin e fondit më të ri të investimeve



Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Mimoza Kaçi, mori pjesë në prezantimin e fondit të qëndrueshëm “Raiffeisen Solid”, nga shoqëria administruese Raiffeisen Invest. Në fjalën e mbajtur në këtë aktivitet, zj. Kaçi theksoi se ky fond, me një strukturë të re investimi të njohur si Master-Feeder, licencuar nga Autoriteti, përfaqëson një nga zhvillimet më të fundit dhe inovatore në industrinë shqiptare të fondeve të investimeve. Fondi gjithashtu integron faktorë mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG) në strategjinë e tij duke ofruar modele investimi të përgjegjshme dhe të qëndrueshme dhe shenjon një hap të rëndësishëm për zgjerimin e mundësive të investimit për qytetarët dhe investitorët shqiptarë.

“Zhvillime të tilla dëshmojnë se ekosistemi financiar shqiptar, dhe në veçanti tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive po bëhet atraktiv për fondet e huaja të investimit, ku vihet re një interes në rritje për ofrimin e produkteve të reja në tregun tonë” - u shpreh Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së.

Autoriteti i ka paraprirë dinamikave të zhvillimit të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, përmes mbikëqyrjes së kujdesshme dhe krijimit të një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe rregullator të përafuar me direktivat dhe rregulloret e BE-së. Mbrojtja e investitorëve është një nga prioritetet kryesore të punës së Autoritetit.

Informacioni gjendet në

<https://amf.gov.al/news.asp?id=43140>

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Mars 2024

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-mars 2024 kapën vlerën 5,227 milionë lekë, ose 1.68% më shumë se në janar-mars 2023. Gjatë periudhës janar-mars 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 310,847 me një rritje prej 8.96% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.99% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës zenë 8.93% dhe risigurimi 0.076%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.30% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.70% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-mars 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,996 milionë lekë, ose 23.88% më shumë se në periudhën janar-mars 2023.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-mars 2024 kapën vlerën 1,358 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 17.57% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-mars 2024 arritën në rreth 3,016 milionë lekë, ose 9.82% më shumë se në periudhën janar - mars 2023.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Mars 2024 (Në %)



ZHVILLIME TË TJERA

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren bazuar në Ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”



Faqe Kryesore ▶ Legjislati ▶ Projektakte ▶ Projektregullore “Për kushtet dhe kriteret e personit juridik që do të veprojë si agjent i

Projektregullore “Për kushtet dhe kriteret e personit juridik që do të veprojë si agjent i fondit të pensionit privat”

📄 Materiali i plotë

Informacioni i plotë:

<https://amf.gov.al/pdf/fokus/Projektregullore-Perkushtetdhekriteretepersonitjuridikqedoteveprojesiagentifpp.pdf>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projektregulloren: “Për kushtet dhe kriteret e personit juridik që do të veprojë si agjent i fondit të pensionit privat”.

Projektregullorja e sipërpërmendur publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm

[Projektregullore “Për kushtet dhe kriteret e personit juridik që do të veprojë si agjent i fondit të pensionit privat”](#)

Autoriteti organizon leksione të hapura me studentë, mbi teknologjinë *BlockChain* e tregjet e kriptomonedhave



Tiranë - 22 prill 2024, leksion me studentët e Universitetit Evropian të Tiranës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi ditën e hënë, datë 22 prill 2024, leksione të hapura me studentët e Universitetit Marin Barleti dhe Universitetit Evropian të Tiranës. Tematika e këtyre leksioneve fokusohet në teknologjinë *BlockChain* dhe tregjet e kriptomonedhave.

Ekspertë të Autoritetit prezantuan panoramën e përgjithshme të ekosistemit të kriptomonedhave, funksionalitetet e ndryshme të tyre, sfidat dhe rreziqet ndaj investitorë, si dhe qasjen rregullatore të Shqipërisë, në funksion të mbikëqyrjes së këtyre tregjeve. Pjesë e leksionit ishte edhe zhvillimi i një anketimi online për të testuar nivelin e njohurive të studentëve për kriptomonedhat.

Leksioni synonte rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar të studentëve për rolin e Autoritetit, si rregullator dhe mbikëqyrës i tregjeve financiare. Zhvillimi i këtij leksioni është pjesë e aktiviteteve, që Autoriteti zhvillon në zbatim të Strategjisë së tij 5-vjeçare për edukimin dhe përfshirjen financiare.

Organizohet trajnimi mbi Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17, në tregun e sigurimeve



Tiranë - prill 2024, 16 prill 2024, trajnim për IFRS 17

Në datat 16-18 prill 2024, u zhvillua trajnimi për Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar, SNRF 17, “Kontratat e Sigurimit”. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka ndërmarrë një sërë hapash për të rritur kapacitet teknike të specialistëve të mbikëqyrjes dhe stafeve teknike të shoqërive të sigurimit në vend, për zbatimin e SNRF 17. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte përvetësimi i njohurive të nevojshme për të kuptuar dhe zbatuar këtë standard në tregun e sigurimeve. Në modulën e parë u trajtuan tematika që lidheshin me: (i) Sfidat kryesore që sjell zbatimi i SNRF 17; (ii) Lidhja e tij me standardin SNRF 9; (iii) Krahasimi me SNRF 4; (iv) Kontratat, testimi dhe kufijtë e tyre; (v) Konceptet aktuariale dhe roli i aktuarëve; etj.

Gjatë trajnimit u analizuan pasqyra financiare të publikuara nga shoqëritë e sigurimeve në vendet e BE-së, si dhe u prezantuan raste studimore. Autoriteti do të zhvillojë edhe dy module të tjera për trajtimin e aspekteve të tjera teknike, që lidhen me zbatimin e SNRF 17.

Ky trajnim u organizua në kuadër të projektit “Forcimi i cilësisë së auditimit dhe raportimit”, financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe administruar nga Banka Botërore.

Zhvillohet testimi për vlerësues dëmsh në sigurime



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në zbatim të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe në kuadër të aktiviteteve për edukim dhe përfshirje financiare, zhvilloi në datat 26 mars dhe 4 prill 2024, testimet për vlerësues dëmsh në sigurime. Testimet u zhvilluan pas trajnimeve të organizuara nga Autoriteti, për kualifikim profesional dhe për edukimin në vazhdim.

Rritja e nivelit të njohurive të vlerësuesve të dëmeve në sigurime, i shërben trajtimit me profesionalizëm të vlerësimit të dëmshpërblimit të të siguruarve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.



Mbikëqyrja e sigurimeve dhe pensioneve për një shoqëri më elastike (Insurance and Pensions Supervision for a more Resilient Society)

*Fjala e Petra Hielkema, Kryetare e EIOPA-s,
në forumin CRO në Venecia, Itali - 21 Mars 2024*

*Marrë me shkurtime dhe redaktime
Vijon nga numri i kaluar*

EIOPA është një organ i pavarur këshillues për Komisionin Evropian dhe Parlamentin Evropian në funksion të mbikëqyrjes së sigurimeve dhe pensioneve profesionale në BE. EIOPA është një nga agjencitë e BE-së që kryen detyra specifike ligjore, teknike ose shkencore dhe këshillon bazuar në evidence, duke ndihmuar në formimin e politikave dhe ligjeve të mirëinformuara si në nivel kombëtar ashtu edhe për BE.

Pjesa II: Hendeku i mbulimit me pension

Tani do të doja t'i drejtohem rrezikut të dytë të mundshëm sistemik që EIOPA po punon për ta trajtuar, dhe ky është boshllëqet në mbulimin me pensione. Peizazhi i pensioneve në Evropë është i fragmentuar, me sisteme të ndryshme në fuqi në të gjithë BE. Megjithatë, telashi me të cilin po përballemi është i përbashkët: evropianët po plaken, po jetojnë më gjatë. Në vetvete, ky është një privilegj dhe një arsye për të qenë mirënjohës. Në të njëjtën kohë, sigurimi i këtij pensioni dinjitoz po bëhet më sfidues.

Për momentin, një ndër pesë qytetar të moshuar në BE është në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social. Në shifra absolute, kjo do të thotë më shumë se 17 milionë njerëz. Mbaj mend që fola për këtë temë rreth 4 vjet më parë dhe në atë kohë, rreth 1 milion evropianë ndikoheshin nga kjo.

Për më tepër, ky rrezik i varfërisë është pothuajse 35% më i lartë për gratë sesa për burrat. Kjo nuk është befasi kur kemi parasysh se pensioni mesatar që marrin gratë është gati 30% më i vogël se ai i burrave.

Kjo është fotografia sot. Kur shikojmë në të ardhmen, shohim probleme të tjera që shfaqen përtej rrezikut të lartë të varfërisë dhe hendekut të madh të pensioneve gjinore. Në dekadat e ardhshme, numri i evropianëve mbi 65 vjeç do të rritet në mënyrë dramatike. Sot për çdo pensionist janë pothuajse tre persona në moshë pune. Duke bërë një parashikim për pas 45 vitesh, do të jetë vetëm gjysma e tyre - 1.5 persona në moshë pune për një person në pension. Dhe pensioni mesatar shtetëror si përqindje e të ardhurave në pension do të bjerë ndjeshëm.

Ky është një problem i ngadalshëm, por serioz, për qytetarët dhe qeveritë. Nëse një pjesë e madhe e popullsisë në plakje përballet me pasiguri financiare gjatë daljes në pension, kjo mund të ndikojë në modelet e shpenzimeve të konsumatorit, rritjen ekonomike dhe mirëqenien e përgjithshme të shoqërive.

Vijon ...

Mbikëqyrja e sigurimeve dhe pensioneve për një shoqëri më elastike

...vijon

Zgjidhja e hendekut në rritje të pensioneve do të kërkojë një përpjekje në shumë faza. Këtu janë disa nga elementët që, sipas EIOPA-s, kontribuojnë në zgjidhje.

Së pari, për të siguruar të ardhura gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme nga pensioni për qytetarët, vendet evropiane duhet të zhvillojnë të tre shtyllat e sistemeve të tyre të pensioneve, që është një sistem pensioni publik ose shtetëror (shtylla 1), skemat e pensioneve profesionale ose të sponsorizuara nga punëdhënësit (shtylla 2), dhe kursime dhe investime individuale ose private (shtylla 3).

Sistemi me tre shtylla, ka përfitime të shumta. Para së gjithash, më shumë stabilitet financiar për qytetarët, sepse ata nuk varen më vetëm nga një pension shtetëror. Pensionet profesionale ofrojnë një mënyrë relativisht të lehtë për njerëzit që të kursejnë drejtpërdrejt nga paga e tyre. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur ka regjistrim automatik. Së fundi, ne kemi nevojë për produkte më të thjeshta të kursimeve afatgjata që njerëzit të investojnë në baza individuale. Rritja e kursimeve të pensioneve, nga ana tjetër, mbështet bashkimin e tregjeve të kapitalit duke kanalizuar kapitalin për të financuar rritjen afatgjatë të ekonomisë reale dhe tranzicionin e saj të gjelbër dhe dixhital.

Evropa ka nevojë për pensione të qëndrueshme që bëjnë të mundur që qytetarët të lulëzojnë, dhe jo thjesht të mbijetojnë. Kur ndihmojmë në krijimin e një grupi demografik që ka para për të shpenzuar, ne gjithashtu zhblllokojmë paratë për tregjet e kapitalit. Dhe së fundi, një sistem në të cilin qytetarët kontribuojnë në mënyrë aktive drejt të ardhurave të tyre pensionale, rezulton në një popullsi më të arsimuar dhe më të sigurt financiarisht, dhe kjo nga ana tjetër mbështet rritjen e ekonomisë së argjendte.

Ne kemi parë prova për këtë. Vendet që kanë një qasje me tre shtylla renditen vazhdimisht në krye për sa i përket besimit të qytetarëve në sistemin e pensioneve, njohuritë e tyre financiare dhe në zhvillimin e ekonomisë së tyre të argjendte.

Pra, zgjerimi i sistemit me tre shtylla në të gjithë BE-në është një element i zgjidhjes. Dhe ne kemi nevojë që qeveritë të mendojnë për këtë.

Pjesa e dytë e zgjidhjes përfshin mbledhjen e të dhënave më të mira dhe rritjen e ndërgjegjësimit për boshllëqet e sistemit të pensioneve. Në fund të fundit, pika fillestare e adresimit të boshllëqeve është të dimë se ku janë ato. Për ta arritur këtë, ne kemi nevojë për mjete: sisteme të përcjelljes së pensioneve për qytetarët individualë dhe panele të pensioneve për politikëbërësit.

Vijon ...

Informacioni i plotë:

https://www.eiopa.europa.eu/in-surance-and-pensions-supervision-more-resilient-society-2024-03-21_en

Mbikëqyrja e sigurimeve dhe pensioneve për një shoqëri më elastike

...vijon

Qytetarët duhet të dinë se çfarë të ardhurash pensionesh do të kenë nga të tre shtyllat. Sistemet e gjurmimit të pensioneve do t'i lejojnë ata të shohin të drejtat e tyre aktuale. Ky informacion do t'i ndihmonte ata të marrin vendime të informuara për shpenzimet dhe kursimet e tyre dhe të marrin përgjegjësi personale për planifikimin e tyre financiar afatgjatë.

Politikëbërësit gjithashtu kanë nevojë për të dhëna. Ata duhet të jenë në gjendje të monitorojnë sistemet kombëtare të pensioneve për të zhvilluar iniciativa që mund të ndihmojnë në mbylljen e boshllëqeve të pensioneve. Mbledhja e të dhënave nga ofruesit privatë të pensioneve mund të mbështesë politikëbërësit në këtë përpjekje. Dhe këtu hyjnë panelet e pensioneve. Jo vetëm për të treguar atë që është kursyer tashmë, por edhe për të lehtësuar një vendim të informuar për veprimet e politikave për të reduktuar hendekun e pensioneve. Vendimet e mira kërkojnë një qasje holistike, bordet e pensioneve e mbështesin këtë.

Prej disa vitesh, EIOPA ka punuar për masa specifike për të adresuar hendekun e pensioneve. Në vitin 2021, ne i dhamë këshilla Komisionit për sistemet kombëtare të gjurmimit të pensioneve si edhe për tabelat e pensioneve. Me afrimin e një cikli të ri politik, ne parashikojmë një vëmendje të përtërirë ndaj këtyre çështjeve.

Sipas këndvështrimit të EIOPA-s, është thelbësore të bëhet hapi i duhur përpara, duke zhvilluar një tabelë të pensioneve në nivel evropian, si dhe tabela kombëtare të pensioneve dhe duke inkurajuar shtetet anëtare të krijojnë një PTS kombëtare dhe të zbatojnë regjistrimin automatik në skemat e pensioneve profesionale. Ne do të bashkëpunojmë me Komisionin në ciklin e ardhshëm politik, duke pasur këto prioritete në mendje.

Paneli i pensioneve dhe sistemet e ndjekjes së pensioneve do të rezultojnë në më tepër transparencë. Por ky është fillimi. Qytetarët do të përfitonin nga informacioni dhe njohuritë më të mëdha financiare për situatën e tyre. Nën atë reja duhet të jenë në gjendje të shohin se si një vendim për të qëndruar në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijën e tyre të vogël do të ndikojë në pensionet e tyre. Të rinjtë që fillojnë karrierën e tyre, ata që janë të pasigurt për financat e tyre ose ata që përballen me vështirësi financiare do të përfitonin nga kontrollet e rregullta shëndetësore financiare.

Njerëzit nuk duhet të fillojnë të mendojnë për pensionet e tyre ndërsa i afrohet pensioni. Dhe kështu ne duhet të promovojmë kursimet e pensioneve dhe të edukojmë njerëzit që herët, mbi rëndësinë e kursimit për të ardhmen e tyre që nga dita e parë e punës së tyre. Dhe kjo do të kërkojë një ndryshim në mentalitetin e evropianëve.

Vijon ...

Informacioni i plotë:

https://www.eiopa.europa.eu/in-surance-and-pensions-supervision-more-resilient-society-2024-03-21_en

...vijon



English

Search

Home About Browse by topic For consumers Tools and data Document Library Media

Home > Insurance and Pensions Supervision for a More Resilient Society

SPEECH | 21 March 2024

Insurance and Pensions Supervision for a More Resilient Society

Speech delivered by Petra Hielkema at the CRO Forum in Venice, Italy on Thursday, 21 March 2024

Këtu ka vend për të pasur një ndikim pozitiv dhe industria ka një mundësi të ketë një rol udhëheqës. Kur njerëzit njohin kufizimet e pensioneve shtetërore, ata bëhen më proaktivë në planifikimin e daljes në pension. Ne e vërejmë këtë tendencë në vende të tjera. Shtetet e Bashkuara janë një shembull i shkëlqyer. Një pjesë e edukimit financiar është të kuptuarit se dikush duhet të marrë një rol proaktiv.

Dhe kjo më çon te faktori i tretë që do të kontribuonte në uljen e hendekut të pensioneve: një shtyllë e tretë më e fortë. Kjo do të thotë më shumë produkte pensionesh që janë të përshtatura për fuqinë punëtore të sotme, mjaft të larmishme. Përkthyes të pavarur, kontraktorë të pavarur, punëtorë të ekonomisë së koncerteve dhe njerëz të tjerë të vetëpunësuar do të përfitonin nga fleksibiliteti më i madh në pensionet private.

Produkti Pan-European i Pensionit Personal, ose PEPP, është një shembull i kësaj. Ai është produkti i parë i pensionit personal i krijuar për të adresuar nevojat e këtij grupi. Është produkt digjital. Është i transferueshëm. Është me kosto efektive. Dhe ende nuk është një sukses. Po pse ndodh kjo? Ndërsa përvetësimi i Produkti Pan-European i Pensionit Personal, ose PEPP është ende i ulët, ne presim që kjo të përmirësohet me kalimin e kohës dhe me përmirësimin e kushteve të ekonomisë. Për më tepër, rregullorja PEPP, e cila filloi të zbatohet dy vjet më parë, po i hap rrugën skemës së re të pensioneve personale vullnetare në mbarë BE-në për njerëzit që të kursejnë për pensionin e tyre. Disa zhvillime të reja, për shembull në Francë, tregojnë se veçoritë e PEPP janë përvetësuar. Me shqyrtimin e këtij legjislacioni nga Komisioni, ekziston mundësia për të bërë më shumë si kjo. Për këtë legjislacion do të jetë e rëndësishme të bëhen tri gjëra:

1. Të shikohet trajtimi tatimor;
2. Të shikohet kufiri i Kostos; dhe,
3. Të mos fokusohet vetëm në elementin ndërkuftar, por në të gjitha tiparet e tjera pozitive që sapa përmenda.

Çelësi është që të lejohen më shumë njerëz të bashkohen me skemat e kursimit të pensionit.

Vijon në numrin e kaluar

Informacioni i plotë:

https://www.eiopa.europa.eu/in-surance-and-pensions-supervision-more-resilient-society-2024-03-21_en

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundvitit të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke, CNB, tregu çek i sigurimeve arriti në 213.15 miliardë CZK ose rreth 8.62 miliardë euro, në fund të vitit 2023 duke shënuar një rritje me 6.52% më shumë se një vit më parë.

Dëmet e paguara nga siguruesit vendas arritën në 108.38 miliardë CZK ose rreth 4.38 miliardë euro, duke shënuar një rënie me 7.44% ku pjesa më e madhe e rënies lidhen me sigurimet e Jo-Jetës.

Për segmentin e Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto (përfshirë risigurimin) mbeti në nivelin e vitit 2022 (rënie e lehtë prej -0.3% në vit) duke arritur në 54.14 miliardë CZK. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me mbi 9% në vit, duke arritur në 158.97 miliardë CZK.

KROACI

www.xprimm.com

Sipas Agjencisë Kroate për Mbikëqyrjen e Shërbimeve Financiare, HANFA, në dy muajt e parë të këtij viti, 14 kompani sigurimesh, që operojnë në Kroaci, kanë arkëtuar 287 milionë euro, nga të cilat 48.7 milionë euro (17%) kanë ardhur nga sigurimet e Jetës dhe 238.3 milionë euro (83%) nga sigurimet e Jo-Jetës.

Në segmentin e Jo-Jetës, pjesa më e madhe e primeve gjenerohet nga sigurimi i përgjegjësive për mjete motorike (36.5%), i ndjekur nga Sigurimi Kasko (19.1%) dhe sigurimet nga zjarri dhe dëmet natyrore (9.7%).

Totali i dëmeve të paguara në dy muajt e parë të 2024 arriti në 219.9 milionë euro. Nga kjo shumë, 85.4 milionë euro (38.9%) janë paguar për sigurimet e Jetës, dhe 134.5 milionë euro (61.1%) për sigurimet Jo-Jetës. Në totalin e dëmeve të paguara për Jo-Jetën, peshën më të madhe e kanë të njëjtat klasa: sigurimet e përgjegjësive për automjetet 41.4%, sigurimi Kasko, 21.1% dhe sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera natyrore 10.4%.

RUMANI

www.xprimm.com

Të dhënat e autoritetit mbikëqyrës për tregun e sigurimeve në Rumani (ASF) tregojnë se siguruesit rumunë (kompanitë lokale) e mbyllën vitin 2023 me një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 3.65 miliardë euro, me një rritje prej 9.45% e shprehur në terma vjetorë. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara ranë me rreth 1.7%, në 1.55 miliardë euro, e shprehur në terma vjetore. Në shifrat e mësipërme duhet të merren parasysh se:

- Të dhënat e tregut të ofruara nga ASF u referohen ekskluzivisht siguruesve të licencuar në Rumani. Për të pasur një imazh gjithëpërfshirës të tregut, shifrave të mësipërme duhet t'i shtohen edhe rezultatet e regjistruara nga siguruesit e huaj që operojnë në regjimet FOE/FOS: me vlerë të primeve të shkruara bruto 0.6 miliardë euro, dëme të paguara 178 miliardë euro.
- Të dhënat e dëmeve të paguara nuk përfshijnë gjithashtu shumat e paguara nga Fondi i Garancisë, të cilat arrijnë në rreth 175 miliardë euro.

Struktura e portofolit të tregut ka mbetur pothuajse e pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Klasat e sigurimeve motorike zënë rreth 76% të sigurimeve të Jo-Jetës, dhe peshën më të madhe e ka linja e biznesit MTPL (52% e biznesit të Jo-Jetës). Ndërsa ritmi i rritjes së segmentit të sigurimit të Jetës ishte më i lartë se mesatarja e tregut me 11.43% më shumë se në vitin e kaluar.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Sektorit Financiar, për tremujorin e katër 2023, të publikuar nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, NBS, në fund të vitit 2023, tregu sllovak i sigurimeve arriti vlerën e primeve të shkruara bruto prej 1.95 miliardë euro, ose 1% më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Segmenti i sigurimeve të Jetës ra me mbi 5% në vit duke arritur në 755 milionë euro. Këto lloj policash gjenerojnë 38.8% të vëllimit total të tregut të sigurimeve. Ndërsa klasat e Jo-Jetës shënuan 1.2 miliardë euro, me një rritje prej 5.5% më shumë krahasuar me vitin 2022.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas është ulur me 7.8% në terma vjetorë, duke arritur në 1.1 miliardë euro, nga të cilat 553 milionë euro kanë të bëjnë me dëmshpërblimet e Jetës, 391 milionë euro lidhen me sigurimet motorike dhe 74 milionë euro, për pagesa për dosjet e dëmeve pronësore.

Sipas të dhënave të tregut të fundvitit të publikuara nga SLASPO (Shoqata Sllovaqe e Sigurimeve), në fund të vitit 2023, vëllim i primeve të shkruara bruto total nga anëtarët e shoqatës (siguruesit vendas dhe filialet e shoqërive të sigurimit nga vendet e BE-së) arriti në 2.72 miliardë euro, duke u rritur me 4.73% në terma vjetorë. Primet e shkruara në sigurimet e Jetës u rritën me 2.44% në vit duke arritur në 1.07 miliardë euro, ndërsa segmenti i Jo-Jetës u rrit me 6.26% në terma vjetorë duke arritur në 1.65 miliardë euro.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al